



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P.2/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.01.2021 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “*Procedurë E hapur*”, me nr. REF-78532-11-12-2020, me objekt “*Dezinfektim i ambienteve të brendshme dhe të jashtme të spitalit dhe poliklika për situatën e krijuar nga covid -19*” me fond limit 8,333,333.00 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 24.12.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit “Ihsan Çabej” Lushnje.
- Ankimues:** “NRG” Sh.p.k .
Rruga “Eduard Mano Pallati nr.10 Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Spitalit “Ihsan Çabej” Lushnje
Lagja Xhevdet Nepravishta Lushnje
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.11.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura “*Procedurë E hapur*”, me nr. REF-78532-11-12-2020, me objekt “*Dezinfektim i ambjentëve të brendshme dhe të jashtme të spitalit dhe poliklinika për situatën e krijuar nga covid -19*” me fond limit 8,333,333.00 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 24.12.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit “Ihsan Çabej” Lushnje.

II.2. Në datën 17.11.2020 operatori ekonomik ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

[...] *Kritere të vecanta të kualifikimit .*

Në DST është përcaktuar tek Kriteret e Vecanta të Kualifikimit 2.3 Kapaciteti Teknik 2.3.1 (a,b,c) Operatorit Operatori Ekonomik duhet të jetë I pajisur e leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (KODI II.8.B). Leje e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, për shërbime ekspertize higjeno-shëndetësore (KODI II.8.A). Leje e lëshuar

nga Qendra Kombetare e Licensimit për "Vlerësimi I ndikimit në mjedis dhe auditimi mjedisor" (KODI III.2.A) Referuar V.K.M. Nr. 538, datë 26.5.2009 "PËR LICENCAT DHE LEJET QË TRAJTOHEN NGA APO NËPËRMJET QENDRËS KOMBËTARE TË LICENCIMIT (QKL) DHE DISA RREGULLIME TË TJERA NËNLIGJORE TË PËRBASHKËTA" objekti i prokurimit është "DEZINFEKTIM I AMBJENTEVE TE BRËNDESHME DHE TË JASHTËME TË SPITALIT DHE POLIKLIKA PER SITUATEN E KRIJUAR NGA COVID -19", ky sherbim është i kategorizuar në Kategoria "II.8" Sherbime te tjera shëndetësore dhe/ose higjieno-sanitare.

Veprimtaritë që kryejnë "shërbime të tjera shëndetësore ose higjieno-sanitare" janë ato të përcaktuara në kategorinë II.8 të shtojcës së Ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"

Veprimtaritë e kësaj kategorie ndahen në dy nënkategori si vijon:

- a) "shërbime ekspertize higjieno-shëndetësore" me kodin II.8.A;
- b) "shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore" të tilla dezinfektimi, deratizimi, dezinfektimi dhe të tjera të këtij lloji me kodin II.8.B.

Në këto kushte mendojmë se vendosja e kriterit Leje e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) për "Vlerësimi i ndikimit në mjedis dhe auditimi mjedisor" (Kodi III.2.A) nuk është në përputhje me objektin e prokurimit dhe duhet të hiqet pasi është në kundërshtim me nenin 46 të LPP. Persa me lart kerkojme qe kriteri Operatori Ekonomik duhet te jete i pajisur me; Leje e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) për shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore (deratizim, dezinfektim, dezinfektim) (Kodi II.8.B). Leje e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (OKL) per sherbime ekspertize higjieno-shendetesore (Kodi II.8.A). Leje e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) per "Vlerësimi I ndikimit ne mjedis dhe auditimi mjedisor" (Kodi III.2.A)

Te modifikohet si më poshtë vijon: Operatori ekonomik duhet të disponojë Licencat si më poshtë vijon: Leje e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) për shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore (deratizim, dezinfektim, dezinfektim) (Kodi II. 8. B). Leje e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) per sherbime ekspertize higjieno-shendetesore (Kodi II.8.A)

Së dyti, Ne DST është përcaktuar tek KRITERET E VECANTA PËR KUALIFIKIM

Kapaciteti teknik 2.3.1 germa d. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar një person përgjegjës për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë prej të paktën 6 muajt e fundit, i cili duhet të bëjë trajnimin teknik të punonjësve të tij mbi masat e sigurimit dhe shëndetit në punë. Operatori ekonomik duhet ta bëjë vete trajnimin (dhe të paraqesë certifikaten perkatese për kryerjen e trajnimeve në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë) ose te kete lidhur një kontratë të rregullt me një kompani për trajnime te tilla apo një punonjës të brendshëm me profesion Irxhinier Mekanik, si Koordinator Sigurie në Punë, vërtetuar kjo me paraqitjen e faturave dhe kontratës së lidhur me subjektin trajnues. Lidhur me këtë kriter kualifikimi të vendosur nga ana juaj, ju sqarojme se: Ky kriter nuk stimulon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë. Autoriteti Kontraktor duke përcaktuar kritere kualifikimi te cilat i ofron vetem një operator ekonomik e ben konkurrimin jo te saktë të drejtë duke mos patur një konkurrim të paanshem ku të gjithë ofertuesit të ofertojnë produktet e tyre.

Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar në - Nenin 23 pika 3 gërma b) përcakton që: Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor duke iu referuar kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri në kërkesat funksionale". Kriteri i vendosur nga ana juaj është vetëm një e dhënë me qëllim eliminimin e konkurrencës në këtë procedurë prokurimi. Ligji Nr. 10 237, datë 18.2.2010 "PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË", neni 7 pika l përcakton se "Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që tmerren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion" dhe pika 3 përcakton se «Punëdhënësi u drejtohet personave ose shërbimeve të specializuara jashtë ndërmarrjes/institucionit, duke hyrë në marrëdhënie kontraktore me ta, nëse kapacitetet e ndërmarrjes/institucionit janë të pamjaftueshme për të organizuar veprimtari për mbrojtjen dhe parandalimin. Punëdhënësi është i detyruar që subjekteve të kontraktuara prej tij, sipas pikës 3 të këtij neni: a) t'u japë të gjithë informacionin për faktorët e njohur ose të dyshuar, që kanë efekte për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve; b) t'u krijojë mundësi për marrjen e informacionit të parashikuar në shkronjat "a" e "b" të pikës l të nenit 12 të këtij ligji. Kriteri Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar një punonjës të kualifikuar për trajnimin e sigurisë në punë është vetëm një kriter që elimimon konkurimin e lire dhe favorizon vetëm një operator ekonomik. Trajnime mbi sigurisë dhe shëndetin në punë mund të kryej cdo person i cili ka aftësi dhe caktohet nga administratori bazuar te gjitha rregulloret në fuqi. Komisioni I Prokurimit Publik në Vendimin e tij nr. 488/ 2020 me numer protokollit 1237 date 07.10.2020, ku komisioni gjykon se kjo kërkesë nuk është në përputhje të plotë me legjislacionin për prokurimin publik dhe atë sektorial në fuqi, pasi është kufizues si kriter. Duke qënë se marrëdhënia e punës është një marrëdhënie dinamike edhe afati 6 muaj i vendosur në këtë kriter është i kundraligjshëm pasi personi përgjegjës për sigurinë në punë mund të jetë i punësuar një ose dy muaj para hapjes së ofertave apo qoftë edhe një javë para këtij afati për arsye se personi përgjegjës paraardhës ka dhënë dorëheqjen apo është larguar nga puna apo ka ndërruar jetë etj etj. Për më tepër kërkojmë që kriteri Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar një Person përgjegjës për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë prej të paktën 6 muaj e fundit, i cili duhet të bëjë trajnimin teknik të punonjësve të tij mbi masat e sigurimit dhe shëndetit në punë. Operatori ekonomik duhet ta bëjë vetë trajnimin (dhe të paraqesë certifikaten përkatëse për kryerjen trajnimeve në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë) ose të ketë lidhur një kontratë të rregullt me një kompani për trajnime të tilla apo një punonjës të brendshëm me profesion Inxhinier Mekanik, si Koordinator Sigurie në Punë, vërtetuar kjo me paraqitjen e faturave dhe kontratës së lidhur me subjektin trajnues.

Të modifikohet

Në zbatim të VKM-së Nr. 108, date 09.02. 2011 "Për afesitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika l.a dhe l.b: Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar një punonjës të kualifikuar për trajnimin e sigurisë në punë (për të cilin duhet të paraqitet certifikata e trajnimit), i cili duhet të bëjë trajnimin teknik të punonjësve të tij mbi masat e

sigurisë dhe shëndetit në punë, i cili duhet të figurojë në listpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën Tetor 2020 ose duhet të paraqesë një kontratë me persona apo shërbime të specializuara në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, jashtë ndërmarrjes, e cila duhet të ketë kohëzgjatje për të mbuluar të gjithë periudhën e ofrimit të shërbimeve që janë objekt i këtij prokurimi.

Së treti, Ne DST është percaktuar tek **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, 2.3** Për kapacitetin teknik, pika 6. Operatori ekonomik duhet të disponojë :Pompa mjergulluese për dezinfektim minimalisht 10 copë dhe me kapacitet 15 L secila me sistemin e inektimit të lëngshëm në gazrat e nxehta, Pompa uvl Pompa në bulizatore për shërbimin në ambiente të brëndshme:

a) Tipi i punës: makineri dezinfektuese, b) Vellimi i kazanit: minimum 5 litra c) Rrjedha e ujit: 60 litra/h, d) Dimensionet e piklave: 5-50 mikron. Ky kriter nuk stimulon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë. Autoriteti Kontraktor duke percaktuar specifikime teknike të cilat i ofron vetëm një operator ekonomik e bën konkurimin jo të drejtë duke mos patur një konkurim të paanshem ku të gjithë ofertuesit të ofertojnë produktet dhe shërbimet e tyre. Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar në - Nenin 23 pika 3 gërma b) përcakton që: "Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombetare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale" Specifikimi i vendosur nga ana juaj është vetëm një e dhënë me qëllim eliminimin e konkurrencës në këtë procedurë prokurimi. Lidhur me këtë kriter sqarojmë sasia e pajisjeve të kërkuar nga AK është e ekzagjeruar dhe thjeshtë një e dhënë për favorizimin e një operatori ekonomik pasi pajisje më të dhënat; Pompa mjergulluese për dezinfektim minimalisht 10 copë dhe me kapacitet 15 L secila me sistemin e injektimit të lëngshëm në gazrat e nxehta, nuk ekziston dhe janë vetëm disa specifikime imagjinare për të favorizuar një operator ekonomik. Themi kapaciteti i depozitës 15L. Cfarë funksioni ka Kapaciteti i depozites? Cfarë ndryshon në cilësinë e shërbimeve nëse kapaciteti i depozites është 2, 3,5 ose 10L? Mbi çfarë baze vlerësohet apo vendoset ky kriter që pompat duhet të kenë kapacitet 15 litra? Ku bazohet AK për vendosjen e këtij kriteri? Të gjitha keto pyetje të nxjerrin në një përgjigje: stimulim vetëm të një operatori ekonomik duke kërkuar specifikime të cilat nuk bëjnë gjë tjetër vetëm eliminon konkurimin e lirë dhe të barabartë. Të dhënat që kanë rëndësi në specifikimet teknike të pajisjes në fjalë janë parametrat që kanë të bëjnë me dimensionet e produktit në hedhje, të cilat ndikojnë në ambientin ku kryhet shërbimi etj. Në gjykimin tonë për të kryer një shërbim në sipërfaqen e dhënë në DST e tenderit janë mëse të mjaftueshme 2 pajisje. Pajisja ULV projektuar për të prodhuar pika shumë të vogla, duke siguruar kështu mbulim uniform me vëllime të reduktuara, madhësia e grimcave që të japi një mbulim dhe depertim të përsosur të produktit në sipërfaqet e trajtuara është 15-20 mikronesh. Pajisjet ULV janë makina me mjergull të ftohtë që trajton vëllime të mëdha ajri në presione të ulta për të kaluar lëngun e përqendruar në pika që shpërndahen në atmosferë, kjo lejon përdorimin e produkteve të përqendruara të shpërndahen në sasi të vogla produkti, në sipërfaqe të mëdha. Për shëmbull, 10,000 metra kub mjedis mund të trajtohet me vetëm 1 litër dezinfektues ose insekticid të përqendruar, përgjithësisht në 30-60 minuta. Kriteri i vënë nga ju "Prurja 60

liter/h nesë bëjme një llogaritje të thjeshtë me 60liter x 10.000m² -6.000.000 m', kjo nënkupton mos funksionimin në mjedis të nebulizimit duke shpërndarë sasi të mëdha produkti. Si një nebulizues me kapacitet 5 liter me një prurje 60lt/h është kontradiktore. Një nebulizator normal do të jetë me i dobishëm duke mos sjelle shqetësime për personelin dhe orendite që ndodhen në ambient. Sipas AK kapacitetit mbajtes i depozites duhet te jet 15litër është një e dhënë tjetër diskriminimi dhe stimulimi të një operatori ekonomik. Mbi çfare baze vleresohet apo vendoset ky kriter qe pajisja ULV të ketë ketë kapacitetit depozite? Ku bazohet AK për vendosjen e këtij kriteri? Çfare funksioni ka në vetvete kapaciteti mbajtes i depozites? Përfundimi është vetem një favorizimi i operatorve ekonomik. Përsa më lart kërkojme që kriteri:Operatori ekonomik duhet të disponojë :Pompa mjergulluese për dezinfektim minimalisht 10 copë dhe me kapacitet 15 L secila me sistemin e injektimit te lengshem ne gazrat e nxehta, Pompa uvl Pompa ne bulizatore për sherbimin ne ambiente të brëndshme:

a)Tipi i punes: makineri dezinfektuese, b)Vellimi i kazanit: minimum 5 litra c) Rrjedha e ujit 60 litra/h, d) Dimensionet e piklave: 5-50 mikron

Të modifikohet

Operatori ekonomik duhet të disponojë: Pomp termofoging 2 cope, secila me sistemin e injektimit te lengshem ne gazrat e nxehta, Pompa uvl Pompa ne bulizatore per sherbimin ne ambiente te brendshme: a)Tipi i punes: makineri dezinfektuese, b)Vellimi i kazanit: minimum 1-7 litra c) Rrjedha e ujit: 0-25 litra/h, d) Dimensionet e piklave: 5-50 mikron.

Së katerti, Në DST është percaktuar tek KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT,
2.3 Për kapacitetin teknik, pika 6 Ofertues duhet të parqesë të dhënat e produktit dezinfektant që do të përdoret në këtë objekt të prokurimit. Specifikimi teknik i produktit: I Dezinfektant me efekt pastrues i lëngshëm i përqëndruar. Perberja kimike: N- (3-amminopropil) -N-dodecilpropan -1 3-diammina.

Te dhënat teknike: Hollimi: 1, 5% - 2% Të luftoje: 1. Baktericide 2. Fungicide 3. Virucide Kunder viruseve te inkapsuluara si psh. (Corona Virus).

Lidhur me kriterin Ofertues duhet të parqesë të dhënat e produktit dezinfektant që do të përdoret në këtë objekt të prokurimit. Specifikimi teknik i produktit: I Dezinfektant me efekt pastrues i lëngshëm I përqëndruar. Perberja kimike: N- (3-amminopropil) -N-dodecilpropan -1 3-diammina.Të dhënat teknike: Hollimi: 1,5% - 2% Të luftojë: 1. Baktericide 2. Fungicide 3. Virucide Kundër viruseve të inkapsuluara si psh. (Corona Virus) sqarojme se AK ka percaktuar të dhënat teknike të produktit pa u preokupuar se Ministria e Shëndetësisë ka percaktuar një list produkte që përdoren për këtë qëllim dhe nuk mund të kufizohet vetëm në një produkt. Fillojmë nga koncepti që në çdo plan dezinfektimi nuk duhet harruar kurrë që trajtimet kunder viruseve, baktereve nuk ka efekt parandalues. Dezinfektimi shërben për të zvogëluar praninë e mikroorganizmave, por efekti i mbetur është i butë, prandaj duhet të përsëritet vazhdimisht ose të jetë në gjendje të llogaritet në një sistem të vazhdueshëm të dezinfektimit. Kjo do të thotë që në situata si kjo që po përjetojmë, duhet të përsëritet ciklikisht disa herë në ditë, në mjedise me rrezik të lartë dhe të ndërmyetëm si në disa zona të spitalit. Për këtë arsye, sugjerimi që ne do të dëshironim të ofronim është përdorimi i pajisjeve që gjenerojnë plazmë të ftohtë dhe që lejojnë sterilizimin e vazhdueshëm të ajrit dhe sipërfaqeve. Kjo pasi kur flasim për

dezinfektim duhet të fillojmë nga një koncept themelor: mjedisi në të cilin jetojmë është i ngopur me ajër, një përzierje

gazi dhe mikroorganizmash. Në një praktikë korrekte të dezinfektimit, eliminimi total i asaj që është prezente nuk mund të arrihet kurrë, por është e mundur të riktheni mjedisin në një prag të pranueshëm të tolerancës, në përputhje me llojin e aktivitetit të kryer në atë mjedis të veçantë. Padyshim që kjo premisë nuk vlen për dhoma të pastra, për sallat e operimit ose reanimacionit ose për shtrimin në spital për pacientët me Covid 19, ku toleranca e mikroorganizmave është afër 0. Kjo është arsyeja pse ka produkte të brezit të ri që, nëse zbatohen në mënyrë korrekte në sipërfaqe me kontakte të shumta ose mundësinë e pranisë së vituseve, kanë një jetë dhe aktivitet që mund të arrihet me shume se 30 ditë. Kërkesa juaj i referohet dezinfektimit tradicional, që është procedura përmes së cilës prania e mikroorganizmave patogjene të pranishme në sipërfaqe dhe pajisje zvogelohet në një nivel sigurie vetëm me mjetet kimike, duke lënë jashtë që normalisht mund të zhvillohet me teknika të ndryshme. Nga kjo mund tju themi se ka produkte shume me shume efektive se sa produkti i kerkuar nga ju, me përbërës aktivë dezinfektues përveç N- (3-aminopropil) -N-dodecilpropan-1, 3-diamin (traminë), të testuar kundër SarsCov2 (kovid), Këto produkte veprojnë në vetëm 60 sekonda, të tilla si familja e peroksimonosulfatit të kaliumit e lidhur me peroksidet dhe surfaktantët, dhe gjithashtu produkte të bazuara në kripëra kuaternare të gjeneratës së 5-të, siç është familja e alkil- benzil- klorur dimetil-amonium, klorur didecil-dimetil-amonium, glutaraldehyd, alkool izopropil autoriteti kontraktor nuk është mjaftuar me dhënien e kritereve mbi kapacitetin teknik por vjen dhe kufizon operatorët ekonomik në produktin e përdorur dhe si të vend listes të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë së Shqipërisë pavarësisht që në këto listë ka produkte shumë efektive lidhur me trajtimet e kerkuar nga AK në DST e tenderit. Do të ishim dakort nëse produkteve në listën e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë nuk do të kryenin funksionin e kërkuar nga AK por ky rast është me të vërtetë flagrant dhe i hapur i favorizimit të një operatori ekonomik. Përsa me lart kërkojmë që kriteri Ofertues duhet të parqesë të dhënat e produktit dezinfektant që do të përdoret në këtë objekt të prokurimit. Specifikimi teknik i produktit: 1 Dezinfektant me efekt pastrues i lëngshëm I përqendruar. Perberja kimike: N- (3-aminopropil) -N-dodecilpropan -1 3 diammina Te dhënat teknike: Hollimi: 1,5% - 2% Te luftoje: 1. Baktericide 2. Fungicide 3. Virucide Kundër viruseve të inkapsuluara si psh. (Corona Virus).

Të modifikohet në

Ofertues duhet të parqesë të dhënat e produktit dezinfektant që do të përdoret në këtë objekt të prokurimit. Specifikimet teknike të produktit duhet të jenë në përputhje me listën e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë së Shqipërisë. Produkti duhet të ketë veprim 1. Baktericide 2. Fungicide 3. Virucide.

II.3. Autoriteti kontraktor me shkresën nuk i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik në lidhje me ankesën.

II.4. Në datën 25.11.2020 operatori ekonomik “NRG” sh.p.k . ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Në datën 17.12.2020, nëpërmjet shkresës nr. 1368/1 Prot., datë 11.12.2020.... me objekt “Dezinfektim i ambienteve të brendshme dhe të jashtme të spitalit dhe poliklinika për situatën e krijuar nga covid -19”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi dëgjoi relatorin e ceshtjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “NRG ” shpk

Në DST është përcaktuar tek Kriteret e Vecanta të Kualifikimit 2.3 Kapaciteti Teknik 2.3.1 (a,b,c) Operatorit Operatori Ekonomik duhet të jetë I pajisur e leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (KODI II.8.B). Leje e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, për shërbime ekspertize higjieno-shëndetësore (KODI II.8.A). Leje e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për “Vlerësimi I ndikimit në mjedis dhe auditimi mjedisor” (KODI III.2.A)

Te modifikohet si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik duhet të disponojë Licencat si më poshtë vijon: Leje e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit QKL) për shërbime nderhyrëse higjieno-shëndetësore (deratizim, dezinfektim, dezinfektim) (Kodi II. 8. B). Leje e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) për shërbime ekspertize higjieno-shëndetësore (Kodi II.8.A) Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1 Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimiti objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori Ekonomik duhet të jetë I pajisur e Leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (KODI II.8.B). Leje e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, për shërbime ekspertize higjieno-shëndetësore (KODI II.8.A). Leje e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për “Vlerësimi I ndikimit në mjedis dhe auditimi mjedisor” (KODI III.2.A)

III.1.2 Me anë të shtojcës “Modifikimi I DST” kriteri I mësipërm është ndryshuar si më poshtë vijon...

Në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik,

Leje e lëshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit për “Vlerësimi I ndikimit në mjedis dhe auditimi mjedisor” (KODI III.2.A) Ky kriter është Hequr.

III.1.2 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “NRG” shpk. KPP, referuar informacionit të autoritetit kontraktor të administruar në dosjen objekt shqyrtimi, parashtrimeve me shkrim të ankimesit, trajtimit të kërkesës nga ana e autoritetit kontraktor si edhe shtojcës mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit publikuar nga autoriteti kontraktor në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, kostaton se nga ana e autoritetit kontraktor është pranuar kërkitimi i mësipërm i operatorit ekonomik ankimes në lidhje me heqjen e lejes së lëshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit për “Vlerësimi I ndikimit në mjedis dhe auditimi mjedisor (KODI III.2.A nga shtojca e dokumentave të tenderit. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, KPP konstaton se, nga e autoritetit kontraktor është reflektuar në sistemin e prokurimeve elektronike ndryshimi përkatës (shtojcë e dokumenteve të procedurës së prokurimit) në lidhje me vendimarrjen e KSHA. Pra, sa më sipër, autoriteti kontraktor në lidhje me pretendimin e mësipërm ka pranuar ankesën dhe ka publikuar shtojcën me ndryshimet përkatëse, në sistemin e prokurimeve elektronike. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, duke qenë se ankesa e operatorit ekonomik “NRG ” sh.p.k. në lidhje me pretendimin e mësipërm, është pranuar nga autoriteti kontraktor, dhe janë pasqyruar edhe ndryshimet përkatëse, në SPE në shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit, rrjedhimisht ky pretendim nuk do të merret në shqyrtim në themel, pasi nuk eksiston më si objekt ankimi.

III.2 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “NRG ” shpk për modifikimin e kriterit *Kapaciteti teknik 2.3.1 germa d. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar një person përgjegjës për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë prej të paktën 6 muajt e fundit, i cili duhet të bëjë trajnimin teknik të punonjësve të tij mbi masat e sigurimit dhe shëndetit në punë. Operatori ekonomik duhet ta bëjë vete trajnimin (dhe të paraqesë certifikaten perkatëse për kryerjen e trajnimeve në fiushen e sigurisë dhe shëndetit në punë) ose të ketë lidhur një kontratë të rregullt me një kompani për trajnime të tilla apo një punonjës të brendshëm me profesion Inxhinier Mekanik, si Koordinator Sigurie në Punë, vërtetuar kjo me paraqitjen e faturave dhe kontratës së lidhur me subjektin trajnues*

Të modifikohet

Në zbatim të VKM-së Nr. 108, date 09.02. 2011 "Për afesitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika l.a dhe l.b: Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar një punonjës të kualifikuar për trajnimin e sigurisë në punë (për të cilin duhet të paraqitet certifikata e trajnimit), i cili duhet të bëjë trajnimin teknik të punonjësve të tij mbi masat e sigurisë dhe shëndetit në punë, i cili duhet të figurojë në listpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën Tetor 2020 ose duhet të paraqesë një kontratë me persona apo shërbime të specializuara në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, jashtë ndërmarrjes, e cila duhet të ketë kohëzgjatje për të mbuluar të gjithë periudhën e ofrimit të shërbimeve që janë objekt i këtij prokurimi. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1 Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit “...Pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik” të

dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Kapaciteti teknik 2.3.1 germa d. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar një person përgjegjës për çeshtjet e sigurisë dhe shëndetit në punë prej të paktën 6 muajt e fundit, i cili duhet të bëjë trajnimin teknik të punonjësve të tij mbi masat e sigurimit dhe shëndetit në punë. Operatori ekonomik duhet ta bëjë vetë trajnimin (dhe të paraqesë certifikaten perkatese për kryerjen e trajnimeve në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë) ose të ketë lidhur një kontratë të rregullt me një kompani për trajnime të tilla apo një punonjës të brendshëm me profesion Inxhinier Mekanik, si Koordinator Sigurie në Punë, vërtetuar kjo me paraqitjen e faturave dhe kontratës së lidhur me subjektin trajnues.*

III.2.2. Në nenin 46, pika 1 germa “b” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “ [...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët 10 ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.2.3. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.2.4. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5 përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

c) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën

III.2.5. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike,

financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomik të kënë të punësuar punonjësin me kualifikimet e nevojshme, certifikatat dhe trajnimet ku te figurojnë ne listpagesat e E-Sig prej te pakten 6 muaj. Në këtë kuptim kërkesa e autoritetit kontraktor përpuësimin e një personi përgjegjës prej 6 muajsh për çështjet e sigurisë dhe shendetit ne punë nuk është e justifikuar referuar natyrës dhe volumit të kontratës tejkalon qëllimin e kriterit dhe ka efektin e kufizimit të pjesmarrjes në rradhët e operatorëve ekonomikë. KPP thekson se, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit (parashikuar nga neni 2 gërma “b” dhe “c” e LPP-së), janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik si dhe nxitja e pjesmarrësve të biznesit të vogël dhe rritjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Në rastin konkret KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin *OE - Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar një person përgjegjës për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë prej të pakten 6 muajt e fundit, i cili duhet te bëje trajnimin teknik të punonjësve të tij mbi masat e sigurimit dhe shendetit në punë. Operatori ekonomik duhet ta bëje vete trajnimin (dhe të paraqesë certifikaten perkatese për kryerjen e trajnimeve në fushen e sigurise dhe shendetit në pune) ose te kete lidhur një kontrateë të rregullt me një kompani për trajnime te tilla apo një punonjës të brendshëm me profesion Irxhinier Mekanik, si Kordinator Sigurie në Punë, vërtetuar kjo me paraqitjen e faturave dhe kontratës së lidhur me subjektin trajnues., duke ulur periudhën për te cilen duhet te figurojë i punësuar ne listpagesat e shoqërise punonjësi përgjegjës për çështjet e sigurisë dhe shëndetit, duke vendosur një diapazon të arsyeshëm, proporcional me objektin me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi.*

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “NRG” shpk për modifikimin e kriterit *KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, 2.3 Për kapacitetin teknik, pika 6. Operatori ekonomik duhet të disponojë :Pompa mjergulluese për dezinfektim minimalisht 10 copë dhe me kapacitet 15 L secila me sistemin e inektimit te lëngshem ne gazrat e nxehta, Pompa uvl Pompa ne bulizatore per sherbimin ne ambjekte te brendshme:*

a) Tipi i punes: makineri dezinfektuese, b) Vellimi i kazanit: minimum 5 litra c) Rrjedha e ujit: 60 litra/h, d) Dimensionet e piklave: 5-50 mikron.

Të modifikohet

Operatori ekonomik duhet të disponojë: Pomp termofoging 2 cope, secila me sistemin e injektimit te lëngshem ne gazrat e nxehta, Pompa uvl Pompa ne bulizatore per sherbimin ne ambjente te brendshme: a) Tipi i punes: makineri dezinfektuese, b) Vellimi i kazanit: minimum 1-7 litra c) Rrjedha e ujit: 0-25 litra/h, d) Dimensionet e piklave: 5-50 mikron. Komisioni I Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

. Operatori ekonomik duhet të disponojë :Pompa mjergulluese për dezinfektim minimalisht 10 copë

dhe me kapacitet 15 L secila me sistemin e inektimit te lëngshem ne gazrat e nxehta, Pompa uvl Pompa ne bulizatore per sherbimin ne ambjekte te brendshme:

a) Tipi i punes: makineri dezinfektuese, b) Vellimi i kazanit: minimum 5 litra c) Rrjedha e ujit: 60 litra/h, d) Dimensionet e piklave: 5-50 mikron

III.3.2 Në nenin 46 pika.1, gërma “b”, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

III.3.3.. Në Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, neni 23 pika 1 dhe 2, përcaktohet se: *“1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik”.*

III.3.4 Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 4 përcaktohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”*

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën

III.3.5 Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në ratin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për mbarëvajtjen e shërbimit, si dhe në zbatim të përcaktimeve të autoritetit kontraktor në grafikun e shërbimit, specifikimet teknike dhe termave të referencës, në të cilën parashikohet të kryhet shërbimi i dezinfektimit brendshme dhe të jashtme për godinen e Spitalit dhe Poliklinikën në Qytetin e Lushnjës, disponueshmëria e pompës ULV më prurje 60litra/h, për kryerjen e shërbimit është një kërkesë jo e domosdoshme dhe kufizuese. Pra, referuar, termave të referencës që janë përcaktuar për këtë shërbim, Komisioni

gjykon se disponimi i kësaj pompe me këtë prurje, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe në tejkalim të asaj çfarë është e nevojshme për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, pasi dezinfektimi mund të të përballohet edhe me një pompë me prurje më të ulët se ajo e kërkuar nga autoriteti kontraktor, pasi qëllimi i shërbimit është dezinfektimi i ambienteve me sasinë e nevojshme, dhe detyrimi i autoritetit kontraktor është të vendosë kërkesa minimale të cilat ofrojnë cilësinë e duhur, në mënyrë që të hapë konkurrencën për të gjithë operatorët ekonomikë të cilët kanë interes për të marrë pjesë në një procedurë prokurimi. Në këto kushte, Komisioni gjykon se atautoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin duke përcaktuar prurjen e pompës në përputhje me sasinë, natyrën dhe objektin e prokurimit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron .

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “NRG ” Shpk 2.3 *Për kapacitetin teknik, pika 6 Ofertuesi duhet të parqesë të dhënat e produktit dezinfektant që do të përdoret në këtë objekt të prokurimit. Specifikimi teknik i produktit: I Dezinfektant me efekt pastrues i lëngshëm i perqendruar. Perberja kimike: N- (3-amminopropil) -N-dodecilpropan -I 3-diammina.*

Te dhënat teknike: Hollimi: 1, 5% - 2% Të luftoje: 1. Baktericide 2. Fungicide 3. Virucide Kunder viruseve te inkapsuluara si psh. (Corona Virus)

Të modifikohet në

Ofertues duhet të parqesë të dhënat e produktit dezinfektant që do të përdoret në këtë objekt të prokurimit. Specifikimet teknike të produktit duhet të jenë në përputhje me listen e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë së Shqipërisë. Produkti duhet të ketë veprim 1. Baktericide 2. Fungicide 3. Virucide.

III.4.1 Në dokumentat e tenderit në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.3 pika 6 “Për kapacitetin teknik ” përcaktohet kriteri si më poshtë:

Ofertuesi duhet të parqesë të dhënat e produktit dezinfektant që do të përdoret në këtë objekt të prokurimit. Specifikimi teknik i produktit: I Dezinfektant me efekt pastrues i lëngshëm i perqendruar. Perberja kimike: N- (3-amminopropil) -N-dodecilpropan -I 3-diammina.

Te dhënat teknike: Hollimi: 1, 5% - 2% Të luftoje: 1. Baktericide 2. Fungicide 3. Virucide Kunder viruseve te inkapsuluara si psh. (Corona Virus)

III.4.2 . Në nenin 23, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se : “1. *Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar: a) standardeve*

kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve 12 teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve; b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

III.4.3. Në nenin 27, pika 1 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet se "Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara".

III.4.4. Në nenin 30 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: "[...]Procedura e hapur është procedura e preferuar në prokurimet."

III.4.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. KPP thekson se, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit (parashikuar nga neni 2 gërma "b" dhe "c" e LPP-së), janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përfshijnë nga konkurimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të

përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 23 të LPP-së, KPP gjykon se, ligjëvendësi ka parashikuar tre metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me referimin e standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo 13 sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. Metoda e dytë e hartimit të specifikimeve teknike lidhet me referimin e kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale. Gjithashtu, edhe metoda e tretë, e cila është një ndërthurje e dy metodave të mësipërme, por çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Autoritet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë me përpikmëri dispozitën e mësipërme të LPP-së në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

III.4.6. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.4.7. Sa më sipër, KPP gjykon se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurentësh me qëllim përfitimin e një malli me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë se autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë parametra teknike kufizues e përjashtues, por duhet të përcaktojë parametra minimalë me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Konkretisht, në këtë rast, referuar edhe pretendimeve të ankimuesit, gjykojmë se përcaktime të tilla si dezinfektant me përberje kimike: N-(3-amminopropil) -N-dodecilpropan -1 3-diammina. janë tregues që nuk ndikojnë në performancën e produktit pra e rëndësishme është që produkti të arrijë qëllimin kryesor pra funksionimin e tij, ndaj KPP gjykon se, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë kufizime të tilla në përcaktimin e specifikimeve teknike për sa kohë që performanca e produktit arrihet me secilën formë përbërësi dezinfektant (pra realizohet performancë pavarësishtspecifikimit të përberjes kimike te saj), në kushtet kur edhe nga ana e autoritetit kontraktor në kthimin e përgjigjes dhe në informacionin e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk jep informacion në lidhje me performancën

e produktit, por i referohet thjesht përberejes kimike të dezinfektantit me të përdorur . Sa më sipër, KPP gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimet teknike në lidhje me sa më sipër, duke aplikuar edhe termin “ekuivalent” me anë të së cilës operatorët ekonomikë mund të dëshmojnë se disponojnë produktet me specifikimet teknike të kërkuara, në funksion të realizimit të synimit dhe kontratës objekt prokurimi. Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron në lidhje me këto kritere dhe autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin përkatës duke përcaktuar termin ekuivalent në lidhje me dhe specifikimin teknik “(dezinfektant me perberje kimike: N- (3-amminopropil) -N-dodecilpropan -1 3-diammina)”.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “NRG” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë E hapur*”, me nr. REF-78532-11-12-2020, me objekt “*Dezinfektim i ambjenteve të brendshme dhe të jashtme të spitalit dhe poliklika për situatën e krijuar nga covid -19*” me fond limit 8,333,333.00 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 24.12.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit “Ihsan Çabej” Lushnje.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “NRG” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1567 protokolloi, Datë. 25.11.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri